

PROCESVERBAL

nga vazhdimi i parë i seancës së 4-ët publike të Këshillit të Agjencisë për
Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive
mbajtur më 04.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm Dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska.

Të pranishmit e tjerë: Ilir Mehdiu, administartor i Radio USKANA-PLUS Kërçovë.

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 4-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në orën 19:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski sqaroi se në seancë do të shqyrtohet vetëm pika nr. 3 e cili ishte shtyrë nga hera e fundit me titull “Arsyetim nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes”.

Pika 3

Arsyetim nga Radio USKANA-PLUS Kërçovë, lidhur me veprimin e medias në lidhje me procedurën e iniciuar për heqjen e lejes:

Përfaqësuesi i medias Radio USKANA-PLUS Kërçovë, z. Ilir Mehdiu, u falënderua për mundësinë e dhënë për të arsyetuar gjendjen aktuale me median. Ai tha se është informuar për afatin ligjor prej 30 ditësh për pagesën e faturës për kompensimin vjetore të lejes, por nuk ka ditur për pamundësinë e pagesës me çesion apo si person fizik. Radioja e ka paguar faturën dy herë, fillimisht me çesion ashtu siç kanë paguar në vitet e kaluara, pa e ditur lajmin për ndryshimin e Ligjit, e më pas si person fizik, por nga të dyja pagesat paratë iu janë kthyer nga Agjencia, sepse Ligji lejon që pagesa të bëhet vetëm nga llogaria e transmetuesit. Ai ka shpjeguar se llogaria e RA USKANA-PLUS është bllokuar nga SHMDMA që nga viti 2017 për mospagesë të të drejtave të autorit (honorareve) dhe më pas SHMDMA në Gjykatën Kushtetuese u është anuluar Rregullorja sipas së cilës është dashur të paguhet. Për atë arsye

radioja bën përpjekje për të zhblokuar llogarinë e tyre që para së gjithash ta paguajnë borxhin ndaj Agjencisë. Në këtë drejtim, ai pyeti nëse ka mundësi që në të ardhmen MIOA t'i japë mundësinë që të paguajë faturën e Agjencisë si person fizik. Ai informon se drejtorit Trajçevski dhe anëtarëve të Këshillit i ka dorëzuar shkresë me të cilën i informojë për gjendjen e radios dhe kërkim të mundësisë për mënyrën e pagesës si person fizik.

Z. Petrushevski deklaroi se shkresën nuk e ka marrë.

Z. Trajçevski sqaroi se mënyrën e pagesës së faturës për kompensimin vjetor për lejen për transmetim televiziv dhe radio nuk e përcakton ASHMA-ja, dhe as MIOA, këto janë ligje që janë në domenin e Ministrisë së Financave. Sipas kësaj, dhe ASHMA e ka ligjërish të ndaluar pranimi i parave me çesione ose nga personat fizik dhe se ndryshimi i ligjit nuk është i ri, mund të jetë para 10 viteve, por çdo vit aplikimi i tij anulohet në mënyrë që ata që kanë llogari të bllokuara të paguajnë me çesione ose nëpërmjet ndonjë personi fizik që do të shlyejë borxhet në emër të tyre. Vitin e kaluar, para skadimit të tij, nuk mështë anuluar zbatimi i Ligjit dhe prandaj Agjencia është e detyruar të veprojë në këtë mënyrë. Ai shpjegoi se transmetuesi duke filluar nga dita e djeshme do të duhet të gjejë mënyrë me SHMDMA për të zhblokuar llogarinë e tyre në mënyrë që të paguajnë faturën, pasi që pas 30 ditësh nuk do të kenë mundësi të kthejnë lejen as përmes gjykatës. Ai thekson edhe një herë se kjo mënyrë e pagesës së faturës nuk varet nga ASHMA-ja apo MIOA, kjo është sipas ligjit që është miratuar kohë më parë në parlament dhe vlen për të gjitha subjektet juridike, private dhe shtetërore.

Z. Petrushevski pyeti nëse ato 30 ditë do të startojnë nga sot apo nga dita e nesërme kur do të nënshkruhet vendimi?

Z. Trajçevski u përgjigj se afatet do të fillojnë që nesër.

Z. Petrushevski sqaroi se edhe drejtori Trajçevski edhe anëtarët e Këshillit janë të kufizuar nga ana e ligjit dhe nuk mund të mos e respektojnë. Të gjithë së bashku u përpoqën për të ndihmuar atë, edhe mediat e tjera. Ai i ka sugjeruar që të konsultohet me TV Shutel sepse kanë arritur marrëveshje me SHMDMA -in dhe kanë paguar faturën.

Përfaqësuesi i medias Radio USKANA-PLUS Kërçovë ka sqaruar se që nesër do të takohen me personat përgjegjës të SHMDMA dhe nëse nuk arrijnë marrëveshje, do të mendojnë nëse do ta mbyllin radion apo do të vazhdojnë punën. Ai pyeti nëse kanë ndonjë informacion nëse institucionet e tjera marrin para me çesione apo nga person fizik, sepse kishte përgjigje nga një institucion i caktuar se kështu tek ata mund të kryhet pagesa.

Z. Petrushevski shpjegoi se nuk mund të thotë se si punojnë të tjerët, ndoshta varet edhe nga cili ligj punojnë.

Z. Trajçevski sqaroi se ky ligj vlen për të gjitha kompanitë private dhe shtetërore, vendimi është nëse dikush do ta respektojë apo jo. Kushdo që lejon pagesa të tilla shkel Ligjin me vetëdije apo pa vetëdije. Ai shpjegoi se nuk është vetëm RA USKANA – PLUS, të cilës i janë kthyer lekët, por ka pasur edhe transmetues të tjerë që duhet tu ktheheshin mjetet.

Z. Petrushevski sqaroi se paratë i janë kthyer edhe TV Shutel, RA Aleksandar Makedonski, procedura është e njëjtë, Agjencia dhe Këshilli nuk kanë qasje të ndryshme ndaj asnjë media.

Z. Fidanoski tha se do të përsërisë disa nga ato që u tha në diskutim. Nga nesër fillon afati 30 ditor i RA USKANA-PLUS për kthimin e lejes. Ka shembuj ku transmetues me procedurë në Gjykatën Administrative e kanë kthyer lejen. Tani ai tha se më e rëndësishme

është që radio të bëjë marrëveshje me SHMDMA për të zhblokuar llogarinë dhe më pas procedura para Gjykatës Administrative dhe tek Agjencia përfundon shpejt.

Z. Ajdini tha se i vjen keq që radioja është vënë në këtë situatë me gjithë dëshirën për të paguar faturën në mënyrë që ata të mund të vazhdojnë punën. Pak më parë përfaqësuesi i radios tha se janë të bllokuar që nga viti 2017, ndaj e pyeti nëse ndërkohë kanë kontaktuar me SHMDMA , nëse mund të jenë gati për ndonjë lloj marrëveshjeje të përbashkët?

Përfaqësuesi i Radio USKANA-PLUS Kërçovë u përgjigj se nesër do të kenë takim me ta dhe deri më tani nuk ka pasur nevojë sepse ka pasur mundësi që të paguajnë me çesion. Ai ka shpjeguar se radioja nuk ka fluks të madh të mjeteve, sepse mundësitë në Kërçovë janë të vogla. Duhet parë nëse ligji lejon fshirjen e borxheve të vjetra apo uljen e kamatës nëse ato janë më të mëdha se borxhi. Ai është i sigurt se Agjencia do të veprojë në përputhje me Ligjin, ai e respekton këtë dhe pajtohet me konstatimin se Agjencia dhe Këshilli kanë gjithmonë qasje të njëjtë ndaj të gjitha mediave në aspektin e vendimmarrjes, por megjithatë ai iu bashkua seancës për të respektuar Këshillin dhe drejtorin edhe pse e dinte se vendimi do të merrej sipas ligjit. Ai edhe një herë deklaroi se respekton punën e ASHMA-së si trup rregullator dhe të Këshillit të Agjencisë.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**